



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR

FAKULTETI I EDUKIMIT DHE SHKENCAVE SHOQËRORE
DEPARTAMENTI I MATEMATIKËS, INFORMATIKËS DHE FIZIKËS

RREGULLORE
E PROGRAMIT TË STUDIMEVE

BACHELOR në "MATEMATIKË-INFORMATIKË"

GJIROKASTËR, 2018



1. TË PËRGJITHSHME

Kjo rregullore është hartuar nga Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë. Ajo mbështetet në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në Statutin e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Rregulloren e Brendshme të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë dhe Udhëzimin Nr. 31, Nr.13334 Prot., datë 29.12.2017 i MASR, "Për Përcaktimin e Kriteve, Dokumentacionit dhe Procedurave për Hapjen, Riorganizimin dhe Mbylljen e Programeve të Studimit nga Institucionet e Arsimit të Lartë".

Me Vendim të MASH "Mbi hapjen e kursit të ri të studimit Matematike-Informatike ne Universitetin e Gjirokastrës", Nr. 4280 Prot, date 1.07.2004, Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës hapi një program të ri studimi Matematike-Informatike për studentet, i cili filloi në vitin akademik 2004-2005. Ky program studimi pesoi ndryshime me kalimin e viteve, e diktuar kjo nga reforma në arsimin e lartë e bazuar në ligjin e ri të arsimit të lartë si dhe nga ndryshimet në tregun e punës për të diplomuarit e këtij programi.

Kjo rregullore është hartuar në përputhje me Rregulloren e Brendshme të Universitetit dhe ka si qëllim të ndihmojë studentet të perceptojë me qarte përmbajtjen e programit të studimit dhe i jep mundësinë atij të përcaktojë programin dhe ritmin e tij gjatë studimeve të tij. Gjithashtu, kjo rregullore synon të specifikojë dhe të përcaktojë qarte disa procedura thelbësore për studimin në këtë program studimi me qëllim që të arrihet asimilimi sistematik i njohurive shkencore dhe zhvillimi i aftësive që do ta bëjnë të diplomuarin në këtë program studimi të aftë për t'iu përgjigjur nevojës bashkohore të prodhimit dhe të mund të vlerësojnë përmbajtjen shoqërore të veprimtarisë së tyre.

2. PROGRAMI I STUDIMIT DHE DIPLOMA

Programi i studimit Matematike-Informatike është program i Ciklit të Parë të studimeve. Në përfundim të tij fitohet Bachelor në Matematike-Informatike.

3. FORMA E STUDIMIT

Forma e studimit në Programin e Studimit Matematike-Informatike është me kohë të plote.

4. PARIME DHE OBJEKTIVA TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Kërkesat gjithnjë e në rritje për përgatitjen e studentëve në shkollat e larta diktohen nga nevojat e progresit të shoqërisë në të gjitha fushat, nga zhvillimi i vrullshëm i shkencës, teknikës dhe teknologjisë.



Sot, shumë probleme të matematikës teorike dhe të zbatuar zgjidhen me kompjuter. Gjithashtu edhe mjaft probleme të informatikës teorike drejtohen më mirë nëpërmjet matematikës. Për më tepër, përpjekjet e matematicienëve të zbatuar në të gjithë botën janë përqëndruar në zhvillimin e programeve (software-ëve) të tilla, të cilat kërkojnë njehsime shkencore komplekse dhe si rrjedhojë njohje të mirë të matematikës, të arkitekturës së kompjuterit dhe të disenjimit të programit. Pra, nevojiten njerëz të kualifikuar dhe të aftë si në matematikë ashtu edhe në informatikë.

Një diplomë për matematikë dhe informatikë njëkohësisht është mjaft fleksibël përsa u përket mundësive që kanë studentët për karrierë dhe punësim. Jo vetëm studentët që janë të apasionuar pas matematikës dhe informatikës, por edhe ata që janë të pasigurt përsa u përket preferencave të tyre prioritare, do ta konsiderojnë këtë diplomë ideale.

Përgatitja dhe kualifikimi i këtyre studentëve do të njihet edhe nga matematikanët dhe nga informaticienët, si dhe do të vlerësohet mjaft edhe nga punëdhënësit e mundshëm.

Ky program studimi synon:

Se pari, një formim baze nëlendet matematike dhe informatike, i cili do të shërbejë për studentet e diplomuar në këtë program studimi qoftë në aspektin e punësimit, qoftë edhe si baze për të vazhduar kualifikimin e mëtejshëm në ciklin e dytë dhe të tretë në matematikë, informatikë apo programe të tjera perkatese integruese.

Së dyti, në krijimin e mundësive për futjen e informacionit të ri nga Informatika dhe lëndet aplikative të Matematikës, i cili do ta bëjë kuadrin e ardhshëm të aftë të mbështesë zhvillimet aktuale dhe të perspektivës në arsim, ekonomi dhe biznes.

Së treti, do të shërbejë si baze për përgatitjen e kontigjentit i cili do të shërbejë si baza e përgatitjes së kuadrit sa më të përgatitur për mesues të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme me drejtim teknik-shkencor, në kushtet e sotme kur ka filluar profilizimi i këtyre shkollave.

Së katërti, studentët që do të mbarojnë këtë program studimi, nuk do të fitojnë thjesht njohuri teorike tradicionale mbi këto fusha, por nga vetë struktura e planit mësimor dhe programeve të diisplinave të parashikuara në të, ata do të fitojnë më tepër njohuri dhe aftësi praktike bashkohore të domosdoshme për t'iu përgjigjur më mirë kërkesave të tregut të punës.

Konkretisht, ata mund të punojnë si :

a) Punonjës specialist në firmat prodhuese ku do të zgjidhin probleme me karakter ekonomiko-informatik duke iu përgjigjur më së miri kërkesave të tyre dhe zhvillimeve të sotme në fushën e teknologjisë së informacionit dhe logjistikës së saj.

b) Mësues të matematikës në shkollat e mesme dhe 9-vjeçare

c) Mësues të informatikës në shkollat e mesme dhe në ato 9-vjeçare. Ky front i punësimit realizon edhe objektivin strategjik të MASR sipas të cilit lënda e informatikës, zë vend më të rëndësishëm në planet mësimore të shkollave të mesme dhe ato 9-vjeçare.



Dhe *së pesti*, ky program studimi do të ndihmojë mjaft edhe për të rritur rolin e universitetit si një qendër e kërkimit shkencor dhe kualifikimit të gjithanshëm në rajon.

5. DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Programi i studimit Matematike-Informatike që çon drejt marrjes së Diplomës Bachelor ne Matematike- Informatike, organizohet dhe shprehet përmes grumbullimit të krediteve sipas Sistemit evropian të transferimit të krediteve (ECTS): Për të fituar kete diplome nevojiten 180 kredite (ECTS). 60 kredite (ECTS) përfaqësojnë ngarkesën e punës së një viti akademik studimesh.

Viti akademik është njësia kohore bazë e studimeve. Një vit akademik përbëhet nga 2 semestra dhe shtrihet në intervalin nga 30 deri 40 javë mësimore, sipas udhëzimeve të MASR-se (30 javë mësim dhe 6-8 javë provime dhe mbrojtje teze diplome).

Viti akademik si rregull, fillon ne muajin tetor te cdo viti dhe perfundon ne 30 shtator te po atij viti. Fillimi dhe perfundimi i vitit akademik percaktohet me Udhëzim te MASR ne cdo fillim viti akademik.

Cdo semester zgjat 15 jave per mesim dhe mesatarisht 3-4 jave per provime.

Datat e sakta te kohezgjatjes se mesimit, pushimeve dhe provimeve percaktohen dhe shpallen nga Departamenti dhe jane te parashikuara ne Strukturen e Vitit Akademik.

Me fillimin e vitit akademik Departamenti shpall orarin mesimor: ditën, orën, sallën dhe personelin akademik perkates, per semestrin perkates.

Kreditet(ECTS) te lendeve paraqiten të bashkangjitura në planin mesimor te miratuar të Programit te studimit. Numri i caktuar i kredive fitohet pas përfundimit me sukses të lendes, siç është përshkruar në këtë Rregullore dhe ne Rregulloren e Brendshme te Universitetit.

Vleresimi i studenteve behet nga personeli akademik perkates qe zhvillon lendet mesimore, i cili detyrohet te organizoje sipas gjykimit te tij kontrole me goje, me shkrim, detyra te pavarura, pune laboratorike etj. ne perputhje me menytrat e vleresimit te percaktuara ne kete rregullore dhe ne rregulloren e brendshme te universitetit.

Studenti perfundon studimet ne kete program studimi dhe merr diplome kur ka likujtuar me sukses gjithe lendet mesimore te parashikuara ne planin mesimor perkates, ka mbrojtur me sukses tezen e diplomes dhe ka fituar 180 kredite (ECTS).

Koha minimale per te perfunduar studimet ne programin e studimeve Matematike-Informatike eshte 3 vjet.

Studenti fillon studimet me atë plan mësimor që i është bërë e njohur atij në ditën e regjistrimit në sekretarinë e fakultetit, gjithmonë në qoftë se i kryen detyrimet në kohën minimale te parashikuar për përfundimin e studimeve në kete program studimi. Në të kundërt ai u nënshtrohet detyrimeve të reja që lindin.

Kohezgjatja e ores se mesimit eshte 50 minuta.



6. ORGANIZIMI I LENDEVE MESIMORE

Sipas veprimtarisë formuese të tyre, plani mesimor organizohet në 5 grupe lëndesh :

- a. Lende baze.
- b. Lende karakterizuese.
- c. Lende ndërdisiplinore/integruese.
- d. Lende plotësuese.
- e. Detyrime përmbylëse.

Programi i studimeve Matematikë-Informatikë përfshin 24 provime dhe 1 teze diplome.

Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet lista e plotë e lendeve mesimore sipas viteve, semestrave, orëve javore të çdo lende mesimore, kreditet përkatëse, menyrat e vlerësimit .



LENDET MESIMORE
PER PROGRAMIN E STUDIMIT TE CIKLIT TE PARE
BACHELOR NE MATEMATIKE-INFORMATIKE

Nr	LENDET MESIMORE	FORMA VLERES.	KREDITET (ECTS)
VITI I			
1	ANALIZE MATEMATIKE 1	Provim	10
2	GJEOMETRI ANALITIKE	Provim	5
3	ALGJEBER 1	Provim	10
4	HYRJE NE SHKENCAT KOMPJUTERIKE	Provim	10
5	TEORI E NUMRAVE	Provim	5
6	FIZIKE	Provim	8
7	LENDE ME ZGJEDHJE (SEMESTRI I)	Provim	6
8	GJUHE E HUAJ	Provim	6
VITI II			
9	ANALIZE MATEMATIKE 2	Provim	10
10	MATEMATIKE DISKRETE	Provim	6
11	ALGJEBER 2	Provim	6
12	ALGORITME&STRUKTURE TE DHENASH	Provim	6
13	PROGRAMIM	Provim	14
14	SISTEME OPERATIVE	Provim	6
15	PROBABILITET & STATISTIKE	Provim	6
16	ANALIZE NUMERIKE	Provim	6
VITI III			
17	PROGRAMIM OOP & GUI	Provim	8
18	TOPOLOGJI & ANALIZE FUNKSIONALE	Provim	10
19	BAZE TE DHENASH	Provim	6
20	EKUACIONE DIFERENCIALE	Provim	4
21	NDERTIM APLIKIMESH NE ACCESS DHE SQL	Provim	7
22	KERKIME OPERACIONALE	Provim	7
23	PROGRAMIM JAVA	Provim	5
24	LENDE ME ZGJEDHJE(SEMESTRI V)	Provim	5
25	TEZE DIPLOME		8

Shenim : Te dhenat lidhur me shpërndarjen e lendeve sipas semestrave, viteve dhe orët perkatese janë pasqyruar në planin mesimor të detajuar bashkangjitur.



7. METODAT DIDAKTIKE

Në programin e studimeve Matematikë-Informatikë, procesi mesidhenes dhe didaktik përfshin metoda të ndryshme didaktike dhe teknika të ndryshme mesmëdhënieje të cilat kontribuojnë në pjesëmarrjen aktive të studenteve dhe në të mesuarin rezultativ. Nder metodat kryesore që përdoren në lende të ndryshme, në varesi dhe të natyrës së tyre janë : leksioni, seminarët, ushtrimet, punët laboratorike, detyrat dhe projektet e kursit, bashkëbisedimi etj.

8. TEKSTET MESIMORE

Materiali didaktik që mbështet procesin mesimor dhe ju sugjerohet studenteve propozohet nga anëtarët e personelit akademik, shqyrtohen në grupet mesimore- kërkimore dhe aprovohen nga Departamenti.

9. FREKUENTIMI

Studenti rekomandohet të ndjekë të gjitha veprimtaritë e procesit mësimor. Në varësi të formës së veprimtarisë mësimore, pjesëmarrja e studentit është fakultative, pjesërisht e detyrueshme dhe plotësisht e detyrueshme si më poshtë:

- a) frekuentimi i leksioneve është fakultativ por i rekomandueshëm.
- b) frekuentimi i seminareve dhe i ushtrimeve është i detyrueshëm në masën jo më pak se 80 % të numrit të seancave të zhvilluara.
- c) Frekuentimi i punëve laboratorike është i detyrueshëm në masën 80 %.

Për format e veprimtarisë mësimore me frekuentim të detyruar të pjesshëm, kur studenti i cili me arsye apo pa arsye nuk merr pjesë në mbi 20 % të numrit të seancave të zhvilluara në një lende, cilësohet i paklasifikuar dhe nuk lejohet të hyjë në provimin e asaj lende. Ai, qoftë si student përseritës në vitin përkatës, apo si student që mund ta mbartë këtë lende në vitin pasardhës, i nënshtrohet të njëjtit rregull të përcaktuar për frekuentim, në të kundërt student i cilësohet përsëri i paklasifikuar në atë lende, duke mbajtur mbi vete përgjegjësinë për pasojat eventuale. I njëjti rregull, por i lidhur me masën e detyrimit përkatës për frekuentim, zbatohet edhe për format e veprimtarive mësimore me frekuentim të plotë të detyruar.

10. VLERESIMI DHE KONTROLLI I STUDENTEVE

Studentet e programit të studimit, me qëllim që studimi i tyre të certifikohet me diplome dhe të marrin Diplomen perkatese të parashikuar, vleresohen:

- në çdo lende mesimore
- në tezen e diplomes

Vlerësimi i studentit ndahet në dy pjesë: **vlerësim i vazhdueshëm dhe**



vlerësim përfundimtar.

Shkalla e përvetësimit të programit mësimor në çdo lende vlerësohet me sistemin prej dhjetë notash. Nota kaluese më e ulët është nota pesë.

Personeli akademik përgjegjës i lëndës mesimore, përcakton nëse e gjykon të arsyeshme, sipas natyrës së lëndës, mënyrën e vlerësimit të vazhdueshëm, të cilën e përcakton me përpara në programin mësimor dhe e pasqyron në planin kalendar dhe në regjistrin e kursit dhe të cilat miratohen nga përgjegjësi i departamentit. Këto mënyra iu behen të ditura studenteve ditën e parë të fillimit të procesit mësimor të lëndës perkatese. Vlerësimi i vazhdueshëm gjatë vitit për lëndet që janë provim përfaqëson **15% deri në 25%** të vlerësimit total. Rezultatet e vlerësimit të vazhduar ju behen të ditura studenteve me mbarimin e procesit mësimor të lëndës mesimore perkatese, përpara provimit të lëndës. Llogaritja e Vlerësimit përfundimtar bëhet sipas përcaktimeve në Rregulloren e Brendshme të Universitetit.

Per lëndet mesiore që kanë në përmbajtje të tyre punë laboratorike :

a) studenti duhet të ndjeke dhe të kryejë punët laboratorike të parashikuara në programin mësimor të lëndës në masën 80%.

b) Në rast se personeli akademik përgjegjës i lëndës ka parashikuar kontroll të pjesshem që mbulon punët laboratorike përpara provimit të lëndës, atëherë mesatarja aritmetike e gjithë vlerësimeve të punëve laboratorike përben vlerësimin që merr studenti në këtë kontroll të pjesshem në përputhje me këtë rregullore.

11. TEZA E DIPLOMES

Studentët në programet e ciklit të parë të studimeve diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome. Pragu i notës mesatare përcaktohet në rregulloren e universitetit, që i jep të drejtë studentit të ciklit të parë të diplomohet, duke përgatitur dhe mbrojtur një punim diplome.

Mbrojtja e punimit të diplomes përmban:

a. Tematika

Punimi i diplomes mund të jetë bibliografikë, kërkimor apo dhe kombinim i të dyjave për çështje që lidhen me lëndët mesimore të planit mësimor të programit të studimit. Një student mund të propozojë vetë një punim diplome dhe ta hartojë atë me kushtin që të marrë miratimin e pedagogut udhëheqës. Punimi i diplomes mund të jetë personale ose në grup (deri të shumten 5 vete). Aprovimi i temës dhe udhëheqësit bëhet nga Departamenti.

b. Forma dhe vëllimi i punimit të diplomes.

Punimi i diplomes nuk mund të kalojë 12 000 fjalet (afërsisht 40 faqe) dhe shprehja e saj duhet të jetë në përputhje me rregullat e një punimi shkencor. Format i saj është standart dhe aprovohet nga Departamenti (bashkangjitur kësaj rregulloreje).

c. Diagrama kohore



- E shumta 1 muaj përpara mbarimit të semestrit të parë të vitit akademik pedagogët janë të detyruar të shpallin me shkrim studenteve propozime temash për tezat e diplomave.
- Me fillimin e semestrit të dytë, studentët zgjedhin temën dhe në marrëveshje me udhëheqsin marrin përsiper tezën e diplomes dhe dorëzojnë një Deklaratë të marrjes së Tezës së Diplomes.
- Koha minimale e dorëzimit të Tezës së Diplomes nuk mund të jetë më e vogël se 8 javë pas marrjes përsiper të saj dhe e detyruar përpara fillimit të sezonit perkates të provimeve të verës apo të vjeshtës.

d. Detyrime të pedagogut udhëheqës

- Shpallja në kohë e propozimeve për temë diplomash që deshirojnë dhe mund të udhëheqin.
- Udhëheqje dhe takime keshilluese në periudha të rregullta kohore me studentët. T'u ofrojnë studenteve udhëzime për shkrimin dhe mbrojtjen e temës si dhe për vlerësimin e saj.
- Çdo pedagog mund të udhëheqë deri në tre temë diplomash njëherësh.

e. Vlerësimi

Punimi i diplomes vlerësohet me sistemin me dhjetë notash përpara një komisioni të ngritur në departament.

12. NJOHJA, EKUVALENTIMI DHE TRANSFERIMI

Është e mundur njohja e plotë dhe e pjesshme e krediteve studenteve që vijnë me transferim nga programe të tjera studimi brenda ose dhe jashtë universitetit.

Për Departamentin ngrihet Komisioni i Njohjes dhe Ekuivalentimit i cili vlerëson dokumentacionin e studentit dhe bën njohjen e krediteve perkatese për lëndët mesimore të likujduara të cilat mbulojnë të paktën 80% të programit të lëndës mesimore për të cilën kerkohet njohja e krediteve.

Modalitetet dhe procedurat për transferimin e studenteve janë të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Universitetit.

13. DISPOZITA TË FUNDIT

Çdo çështje që lind nga zbatimi i kësaj rregulloreje dhe nuk mbulohet prej saj, rregullohet me Rregulloren e Brendshme të Universitetit. Në rast se edhe kjo e fundit nuk e mbulon, atëherë departamenti i propozon Rektorit dhe Senatit Akademik propozimin perkates për miratim.

14. OBJEKTIVAT SPECIFIKE DHE KURRIKULAT E LENDEVE

Bashkangjitur kësaj rregulloreje gjenden kurrikulat e lëndëve perkatese të ofruara



studenteve në Programin e Studimit Matematikë-Informatikë me kohë të plote.

